



INFORMACIONE

PASQYRA E AKTIVITETEVE TE MUAJIT PRILL

KOKSH & Sekretariati i Komitetit Olimpik Europian (COE)

Sukses në Vendosjen e partneritetit, "AMC",
"Raiffeisen Bank" dhe "Tirana Airport Partners"

Mbërrijnë në Tiranë Presidenti dhe anëtarët e Komitetit
Ekzekutiv të COE.

Presidenti Domi, uron mirëseardhjen dhe çel mbledhjen
e Komiteti Ekzekutiv të COE

Darka e Mirseardhjes e përfaqësuesve pjesmarrës në
Seminar ofruar nga Presidenti i KOKSH.

Maj Presidenti i "Pescara 2009", takim me Presidentët
dhe Sekretarët e Federatave Sportive Shqiptare.

Komiteti Organizator i "Almeria 2005" - takim pune

Çelet Seminari i 26-të i Sekretarëve të Përgjithshëm dhe
Shefave të Misionit të COE, përshëndet Kryeministri Nano

Urdhëri Olimpik "Skënderbeg" Presidentit të Komitetit
Olimpik Europian

COE Seminar, darkë zyrtare në Pallatin e Brigadave

Konferencë për shtyp : COE – OS – KOKSH

Stafi Organizator i Seminarit dhe Vullnetarët.

Bursa Mesdhetare - Gjymnastja Ornela Çuko trainim
stërvitor në Itali

Java Olimpik Peshkopi 2005

Mbledhje e Tutorëve dhe Lektorëve të KOMPAS

Ceremoni e Dhenies se Urdherit Olimpik z. Irfan Tershana

Mbledhje e KE Komiteti Ekzekutiv i KOKSH

Mbledhje e Sekretarëve të Federatave për "Almeria 2005"

Federata Europiane e Pingpongut – Vizite e Presidentit
Stefano BOSSI (ETTU)



2 Maj - KOKSH & Sekretariati i Komitetit Olimpik European (COE)

Në Hotel Sheraton që prej datës 2 Sekretariati i COE dhe KOKSH transferohen për të startuar punën operative të drejtpërdrejtë për përgatitjen e materialeve të si dhe u zhvillua takimi i fundit me vullnetarët për masat organizative.

3 Maj - Sukses në Vendosjen e partneritetit, "AMC", "Raiffeisen Bank" dhe "Tirana Airport Partners"

Sekretari i Përgjithshëm i KOKSH Stavri Bello dhe Drejtori i Përgjithshëm i Tirana Airport Partners z. Vandefeuer rane dakord për të krijuar lehtësira ekskluzive për delegatët që do të mbërrin në Aeroportin Nënë Tereza, i cili drejtohet tashme nga Shoqëria **Tirana Airport Partners**. Kjo marrëveshje rezultoi në një pikë kyce të suksesit të evenimentit.

- **AMC** – Kompania AMC ishte një partner tjetër që ndihmoi në shpalosjen e vlerave të evenimentit. Me kontributin e saj financiar, kjo kompani siguroi lehtësirat e domosdoshme të organizimit që kanë të bëjnë me transportin, pajisjet e teknologjise audiovizuale dhe në fund, AMC ishte ajo që ofroi Darkën festive të Lamtumirës së këtij seminari.

- **Raiffeisen Bank** – është partneri më i ri i këtij eventi interesant, e cila u bë një nga sponsorët e evenimentit të prezantuar me

krenari nga KOKSH. Mbështetja Financiare e Raiffeisen Bank në realizimin e setit promocional të evenimentit, padyshim që ka rëndësinë e saj absolute në këtë eveniment.

- **ALUMIL** - Falenderime gjithashtu kompanisë **ALUMIL**, që ishte një nga sponsorët e aktivitetit.

4 Maj - Mbërrijnë në Tiranë Presidenti i COE dhe anëtarët e Komitetit Ekzekutiv të COE.

Presidenti i COE, z. Mario Pescante mbërriti në Tiranë në kuadër të Seminarit të 26-të të Sekretarëve të Përgjithshëm dhe Shefave të Misionit të Komitetit Olimpik European (COE), bashkë me të mbërritën edhe zv. Presidenti dhe Sekretari i Përgjithshëm i COE.

Presidenti Pescante, zhvilloi një takim në Ministrinë e Kulturës Rinisë dhe Sporteve.



Z. Domi gjatë mbledhjes së KE të COE

5 Maj - Presidenti Domi /Uron Mireseardhjen dhe çel Mbledhjen e KE të COE.

Presidenti i KO-KSH z. Hysen Domi dhe Sekretari i Përgjithshëm Stavri Bello, çelin me fjalën e tyre të mirëseardhjes mbledhjen e radhës të Bordit Ekzekutiv të Komitetit Olimpik European. "Për Tiranën është një nder i vecantë të mikpresë Bordin Ekzekutiv të COE në një mbledhje të tij, dhe në këtë kuadër





Mbledhja e Komitetit Ekzekutiv të COE-Tiranë

gjejmë rastin të falënderojmë COEn për mbështetjen e dhënë KOKSHit në vite nga COE” ishte pjesë e mesazhit të Presidentit Domi, ceremoni e cila u zhvillua në hyrje në prani të medias. Në Hotel Sheraton, Salla “Illyria”, një ditë para fillimit të Seminarit të 26-të të Sekretarëve të Përgjithshëm dhe Shefave të Misionit, u zhvillua mbledhja e Komitetit Ekzekutiv të COE. Presidenti i COE Mario Pescante, zv. Presidenti Alexander Kozlovsky, Sekretari i Përgjithshëm Patrick Hickey dhe të gjithë anëtarët e Komitetit Ekzekutiv të COE ishin të pranishëm dhe i shprehën falenderimet më të përzemërta Presidentit dhe Sekretarit të Përgjithshëm të KOKSH për mikpritjen dhe mënyrën e shkëlqyer të organizimit që KOKSH dhe stafi i tij po punon për mbarëvajtjen e këtij aktiviteti. Më pas mbledhja u zhvillua sipas rendit të përcaktuar të ditës.

5 Maj - Presidenti i “Pescara 2009”, takim me Presidentët dhe Sekretarët e Federatave Sportive Shqiptare.

z. Sabatino Aracu Presidenti i “Pescara 2009” dhe delegacioni i tij që kishin ardhur për të

marrë pjesë në seancat e Seminarit të 26-të të Sekretarëve të Përgjithshëm dhe Shefave të Misionit të COE, zhvilluan në Hotel Europapark një takim me Presidentët dhe Sekretarët e Federatave Sportive Shqiptare. Objekti i këtij takimi ishte mbi informimin dhe masat e marra nga Komiteti Organizator i Lojrave Mesdhetare “Pescara 2009”. Vlen të përmëndim këtu edhe kontributin e Ambasadës Italiane për vëmendjen ndaj delegacionit të “Pescara 2009”.

5 Maj - Darka e Mirseardhjes e përfaqësuesve pjesmarrës në Seminar ofruar nga Presidenti i

KOKSH.

Mbas mbledhjes së Komitetit Ekzekutiv të COE, Presidenti i KOKSH shtroi në Hotel Europapark darkën e mirseardhjes në nder të përfaqësuesve pjesmarrës të 48 Komiteteve Olimpikë Europiane dhe përfaqësuesve të vendeve candidate të Lojrave Olimpikë, Mesdhetare, Festivaleve Rinore Eurpiane (EYOF). Të ftuar në këtë darkë ishin edhe anëtarët e K.E. të KOKSH, përfaqësues të Ministrive përkatëse që kanë bashkëpunuar me KOKSH për organizimin e Seminarit dhe përfaqësues të sponsorve Raiffeisen Bank, Kompanisë Celulare AMC dhe Kompanisë ALUMIL.

6 Maj - “Almeria 2005”

– Komiteti Organizator i “Almeria 2005” zhvilloi një mëngjes pune me Komitetet Olimpikë Kombëtare të pranishëm në seminarin e COE por që i përkasin pjesëmarrësve në Lojrat Mesdhetare. Të pranishëm në këtë takim prezantues të realizimeve dhe të rejave nga “Almeria 2005” edhe Sekretari i Përgjithshëm Bello.

6 Maj - Seminari i 26-të i Sekretarëve të Përgjithshëm dhe Shefave të Misionit të COE

Në Tiranë, datë 6 Maj 2005 në Sallën "Illyria" të Hotel Sheraton u zhvillua Ceremonia zyrtare e hapjes së Seminarit të 26-të të Sekretarëve të Përgjithshëm dhe Shefave të Misionit të COE. Në prani të Presidentit, zv. Presidentit, Sekretarit të Përgjithshëm të COE, Komitetit Ekzekutiv të COE dhe të gjithë përfaqësuesve pjesmarrës të 48 Komiteteve Olimpikë Europiane dhe përfaqësuesve të vendeve kandidatë të Lojrave Olimpikë, Mesdhetare, Festivaleve Olimpikë Rinore Europiane (EYOF), hapjen e Seminarit të COE e përshëndeti me prezencën e tij Kryeministri i Republikës së Shqipërisë z. Fatos Nano. Pas fjalës përshëndetëse të Presidentit të COE Mario Pescante i cili në emër të 48 vendeve përgëzoi qeverinë Shqiptare dhe në veçanti KOKSH që për herë të parë Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar bëri të mundur të sjellë në Shqipëri një numër kaq të madh përfaqësuesish të vendeve të Europës. Nga ana e tij, Kryeministri Nano përshëndeti pjesmarrjen e të gjithë delegatëve të cilët kanë mundësi të shohin më nga afër Shqipërinë dhe mikpritjen e saj dhe gjithashtu në mënyrë të veçantë shprehu vlerësime për KOKSH në këtë sipërmarrje dhe deklaroi që KOKSH do të ketë padyshim vëmendjen e qeverisë. Në këtë seminar, morën pjesë gjithashtu Komitetet Organizatore të

KOKSH i ka dhënë urdhërin Olimpik "Skënderbeg" Presidentit të Komitetit Olimpik Europian z. Mario Pescante me motivacionin : " Për kontributin e tij të veçantë në zhvillimin e Lëvizjes Olimpikë Shqiptare". Çmimi i'u dha nga Presidenti i KOKSH z. Hysen Domi gjatë Seminarit të 26-të të Sekretarëve të Përgjithshëm dhe Shefave të Misionit të COE i cili u zhvillua në Tiranë më 6-7 Maj 2005.



Mario Pescante - "Urdhri Olimpik Skënderbeg"

Lojrave Olimpikë "Torino 2006", "Pekin 2008", organizator të Festivaleve Olimpikë Europiane e të Rinjëve të Monthey "2005", Lignano "2005", qytetet kandidat të "Jaca 2007" dhe "Beograd 2007", për Lojrat Mesdhetare "Almeria 2005" dhe "Pescara 2009". Takimi në Tiranë ishte mundësia e fundit e 5 qyteteve kandidatë për Lojrat Olimpikë Verore që të zhvillojnë takime zyrtare me përfaqësuesit e 48 Komiteteve Olimpikë të Europës. Por një pjesë shumë e rëndësishme në këtë Seminar ishte prezantimi i Programeve botërore të Solidaritetit Olimpik të cilat u prezantuan nga Pere Miro, Drejtor i SO dhe Pamela Vipond zv/Drejtoresh e programeve të SO. Në një nga seancat e kësaj mbledhjeje u vendos që Seminari i ardhshëm të mbahet në Bukuresht të Rumanisë në Qershor të 2006.



Kryeministri Nano përshëndet seminarin e COE, Tiranë

6 Maj - KOKSH shtron Darkë Zyrtare në Pallatin e Brigadave.

Me ftesë drejtuar autoriteteve më të larta të Qeverisë Shqiptare të ftuar për të nderuar me pjesëmarrjen e tyre në darkën Zyrtare. Trupat Diplomatikë dhe autoritetet kryesore të institucioneve dhe partnerëve të organizimit të këtij evenimenti ishin të pranishëm në darkën Elegante të Shtruar në Pallatin e Brigadave, një pjesë mbresëlënëse për nga historia dhe domethënia e saj për të gjithë të pranishmit.

7 Maj - Dita e dytë e seminarit të COE

Vazhdoi punimet me prezantimet e Komiteteve Organizatore të qyteteve kandidate për zhvillimin e Lojrave të ndryshme dhe prezantimet e aktiviteteve tashmë të përcaktuara për punën e bërë dhe masat e marra për organizimin e aktiviteteve. Mbas përfundimit të aktivitetit, sipas programit të parashikuar, delegatët vizituan Muzeun Historik Kombëtar Shqiptar ku shkurtimisht u njohën me historinë e vendit tonë në shekuj. Në mbrëmje të ditës së dytë ku gjithçka zyrtare ishte ezauruar, në House of Arts, u organizua Darka e Përcjelljes së Delegatëve.

7 Maj - Konferencë për shtyp : COE – OS – KOKSH

Në përfundim të evenimentit dhënë në kuadër të mbylljes me sukses të Seminarit të 26-të të Sekretarëve të Përgjithshëm dhe Shefave të Misionit të COE Zv. Presidenti i Komitetit Olimpik Europian njëkohësisht anëtar me titull i Komitetit Olimpik Ndërkombëtar z. Aleksander Kozlovski; Sekretari i Përgjithshëm i COEs z. Patrick Hickey; Drejtori i Solidaritetit Olimpi z. Pere Miro; Presidenti i KOKSH Hysen Domi dhe Sekretari i Përgjithshëm Stavri Bello.

“Një sukses i jashtëzakonshëm dhe i realizuar në standartin më të lartë, përshtypje të jashtëzakonshme për Shqipërinë dhe Njerëzit e saj; mbresat më të shkëlqyera për Komitetin Organizator dhe vlerësimet maksimale për KOKSH që gjithashtu ka ditur të zgjedhë partnerëtë spikatur në organizimin e këtij evenimenti” – ishte esenca përmbledhëse për organizimin.

Presidenti i COE z. Mario Pescante në letër mesazhin e tij përmbyllte vetëm me një fjale “BRAVISSIMI”.

Stafi Organizator i Seminarit dhe Vullnetarët

Vlerësim mjaft i madh vjen për punën e stafit Organizator dhe Vullnetarëve të Seminarit të 26-të të Sekretarëve të Përgjithshëm dhe Shefave të Misionit të COE të cilët për mëse një javë rresht kanë qënë të angazhuar seriozisht në detyrat dhe punët organizative të Seminarit. Ky vlerësim vjen si nga anëtarët e Komitetit Ekzekutiv të COE por edhe nga të gjithë pjesëmarrësit që me të vërtetë kanë ndjerë gjallërinë, ngrohtësinë, angazhimin dhe seriozitetin e tyre.



Gjatë ceremonisë së falenderimit të vullnetarëve

14 Maj - Bursa Mesdhetare - Gjymnastja Ornela Çuko trainim stërvitor në Itali.

Në kuadër të përgatitjeve për Lojrat Mesdhetare “Almeria 2005” të cilat do të zhvillohen në Spanjë në muajin Qershor, KOKSH i ka mundësuar gjymnastes Ornela Çuko një trainim stërvitor10

ditor në kampin stërvitor "Acquacetosa" të CONI, Romë-Itali. E shoqëruar nga Traineri i saj z. Ferdinand Mara, financimin e të cilit e mundësoi FSHGJ, sportistja do të zhvillojë këtë training së bashku me ekipin Kombëtar Italian të Gjymnastikës artistike për femra.

17-21 Java Olimpikë Peshkopi

Në qytetin e Peshkopisë, me mbështetjen e KOKSH, Komiteti Olimpik Rajonal Peshkopi, ka organizuar Ditën Olimpikë të Vrapimit dhe Javën Olimpikë. Me pjesmarrjen e dy shkollave të mesme "Seid Najdeni", "Nazmi Rushiti" dhe 4 shkollat nëntëvjeçare të qytetit të Peshkopisë "Demir Gashi", "Selim Alliu", "Irfan Hajrullai" dhe "Myslim Shehu", për një javë rresht në qytetin e Peshkopisë janë organizuar aktivitete të ndryshme sportive-kulturore. Aktivitetet sportive të zhvilluara nga data 17-22 Maj kanë qenë të larmishme, duke përfshirë vrapime të distancave të ndryshme sipas kategorive të moshave, lojra sportive të disiplinave të ndryshme futboll, basketboll, volejboll, etj. dhe takime finale midis shkollave. Në fund të aktivitetit 6 ditor, u shpërndanë çmime dhe çetifikata për pjesmarrësit. Ky aktivitet u mbështet nga KOKSH

dhe pati vëmendjen e bashkëpunimit të Bashkisë Peshkopi, Drejtorisë Arsimore Dibër dhe Klubit Sportiv "Korabi"

25 Maj - Mbledhje e Tutorëve dhe Lektorëve të KOMPAS

Në ambjentet e KOKSH u zhvillua mbledhja e njoftuar me Lektorët dhe Tutorët e kurseve rajonale të Administratorëve Sportivë dhe kursit KOMPAS. Objekti i këtij takimi ishte diskutimi për të bërë një vlerësim dhe për të vendosur në lidhje me rifillimin e kursit KOMPAS III. Megjithëse ishin të ftuar nga tre institucionet MKRS, KOKSH dhe AEFS "Vojo Kushi", partnere në dy kurset e zhvilluara KOMPAS I dhe II, përfaqësuesit e MKRS nuk ishin të pranishëm në këtë mbledhje. Megjithatë, nga të pranishmit në takim, diskutuan edhe për vlefshmërinë e njohjes së kursit KOMPAS duke e kaluar atë në planin akademik të nivelit pasuniversitar duke pasur gjithmonë një bashkëpunim ndër-institucional midis MKRS, MASH, KOKSH dhe AEFS "Vojo Kushi" dhe diploma e këtij kursi të jetë unike. Në fund të takimit u vendos që të bëhet një mbledhje tjetër në muajin Shtator 2005 me objektivin që KOMPAS III të fillojnë në Janar 2006.

19 Maj - Ceremoni e dhënies së Urdhërit Olimpik z. Irfan Terhana Nderim i KOKSH për & 100 vjetori i lindjes së Arkitektit

KOKSH ka patur kënaqësinë e vecantë të organizojë këtë ceremoni koktejl për nder të Arkitektit të nderuar z. Irfan Terhana, konstruktor i më se 350 ndërtimeve dhe në mënyrë të vecantë i atyre sportive në Shqipëri. Të pranishëm, Presidenti Hysen Domi, Sekretari i Përgjithshëm Stavri Bello, anëtarë të Komitetit Ekzekutiv të KOKSH, Shefi i Misionit dhe Kryetar i Komisionit Teknik të KOKSH z. Fidel Ylli; ish-presidenti i KOKSH Arben Jorgoni, Skënder Begeja, figura të shquara dhe veteranë



Pamje nga Dita Olimpikë e Vrapimit - Peshkopi 2005



Ceremonia e dhënies së Urdhërit Olimpik z. Irfan Tershana

të lëvizjes sportive shqiptare, Dr. Hysni Ndoja nga Shkodra, z. Suat Jegeni, etj. Prof. Adriano Cani për Ambasadën Italiane, z. Ismet Bellova, Miq e dashamirës..

Presidenti Hysen Domi në fillim të ceremonisë në fjalën e tij tha “Shëmbulli i vlerave të pakundërshtueshme të një personaliteti të paarrtshëm si ai i z. Irfan Tershana, me jep nderin që në vlerësim të kontributit të tij, për lëvizjen sportive, ti akordoj Urdhërin Olimpik”

Prof. Dr. Arben Jorgoni, ish President i Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar do të shprehej:

Inxhinier Irfan Tershanës është një kulm jo fizik, sa shpirtëror, moral, profesional, patriotik. Ai kurrë nuk i ka vlerësuar arritjet e tij të panumërta në arkitekturën sportive, si fitore të vecanta, por i ka parë se sa gëzim kanë dhënë ato, tek njeriu dhe ushtruesit e shumtë, si dhe tek vetja e tij, se sa shumë është përpjekur të bejë më të mirën. Kjo moto origjinale e shëmbullit olimpik të Irfanit, mishëron në praktikë kredon e Olimpizmit ‘Më shpejt, Më lart & Më Fort’!

27 Maj - Mbledhje e KE te KOKSH

Komiteti Ekzekutiv i KOKSH në datën 27 Maj, në ambjentet e KOKSH zhvilloi mbledhjen e katërt të radhës. Në këtë mbledhje, KE i KOKSH kishte në rendin e ditës:

- Konkluzionet e Seminarit të 26-të të Sekretarëve të Përgjithshëm dhe Shefave të Misionit të COE në Tiranë, datë 6-7 Maj.

- Lojrat Mesdhetare “Almeria 2005”
- Festivali Olimpik Rinor European “Lignano 2005
- KOMPAS III
- Të ndryshme

Gjatë diskutimit të pikës së parë, të ftuar ishin edhe Vullnetarët e Seminarit të 26-të të Sekretarëve të Përgjithshëm dhe Shefave të Misionit të COE, të cilët morën vlerësimin nga KOKSH për angazhimin e shkëlqyer. Shefi i Misionit të KOKSH z. Fidel Ylli shpërdau çertifikatat e dedikuara për vullnetarët dhe stafit të KOKSH, në kuadër të përfshirjes së tyre në oraganizimin e këtij aktiviteti.

30 Maj - Federata Europiane e Pingpongut Vizite e Presidentit Stefano BOSSI (ETTU)

Në perfundim të vizitës së tij 3 ditore të punës Presidenti i ETTU (Bashkimit Europian të Ping Pongut) u prit në një takim pune nga autoritetet më të larta të KOKSH. Takimi kishte për objekt perpjektjet për të ristrukturuar dhe zhvilluar një ping pong bashkëkohor dhe një komunitet më aktiv të bazuar mbi baza bashkëkohore. E pranishme edhe menaxherja e Projekteve të Zhvillimit të ETTU, znj. Zita Pidl. Kjo vizitë u konkludua me një konferencë Shtypi të përbashkët në KOKSH, të dhënë nga: Presidenti i KOKSH Hysen Domi dhe Presidenti i ETTU Stefano Bossi, me praninë ndërmjet të tjerëve edhe të Shefit të Misionit Fidel Ylli, Presidentit të FSHP Arben MECE, Sekretari i Përgjithshëm Astrit Hutka, dhe Drejtorja e Departamentit të Zhvillimit të ETTU Zita Pidl.



Vizita e Presidentit të ETTU, z. Stefano Bossi

30 Maj - Mbledhje e Sekretarëve të Federatave për "Almeria 2005"

KOKSH në kuadër të përgatitjeve për Lojrat Mesdhetare "Almeria 2005", zhvilloi një takim me Sekretarët e Përgjithshëm të Federatave Sportive Shqiptare, pjesmarrëse në Lojrat Mesdhetare "Almeria 2005". Qëllimi i takimit ishte mbi informimin e mënyrës së udhëtimit dhe akomodimit të sportistëve, datat respektive të nisjes dhe mbërritjes, etj. Gjithashtu Sekretari i Përgjithshëm i KOKSH informoi pjesmarrësit në takim mbi mënyrën e planifikimit, të ndarjes dhe mbulimit të shpenzimeve të sportistëve që bëjnë



Mbledhja e KE të KOKSH

pjesë në projektin që KOKSH i ka paraqitur MKRS.

C
I
T
I
U
S

A
L
T
I
U
S

F
O
R
T
I
U
S



Kolazh nga Seminari i COE

